



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 463/01-29978 dt: 29 Maj 2026

Në bazë të nenit 12 par.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 në mbështetje të nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenit 17 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Nr. 32/2026

Mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Parcelës Komunale 4560-23, pronë komunale me sipërfaqe 6735m² Zona Kadastrale Pejë, cila është e destinuar për dhënien në shfrytëzim nga procedurat e këmbimit dhe shpronësimit.

1. **MIRATOHET** - Vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Komisioni vlerësues sipas këtij vendimi përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si me poshtë:
 - 2.1. Atdhe Berisha - anëtarë i kuvendit nga subjekti LDK, anëtarë,
 - 2.2. Edonjeta Berisha - anëtarë i kuvendit nga subjekti PDK, anëtarë,
 - 2.3. Albulena Mujaj Bajraktaraj – anëtare nga ekzekutivi i komunës – Drejtoreshë në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale
 - 2.4. Luan Vocaj – anëtar nga ekzekutivi i komunës - Drejtor në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim
 - 2.5. _____ anëtarë nga sektori joqeveritar anëtarë.
3. Kryesuesi i Komisionit vlerësues zgjidhet me shumicë votash nga radhët e anëtarëve të Komisionit Vlerësues.
4. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit Vlerësues janë: përpilimi i njoftimi publik me të dhënat për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, prezenca në ankand publik, hapja e ofertave, vlerësimi final i ofertave në pajtim me kriterët e përcaktuara me njoftimin për ankand publik dhe shprehje të interesit, si dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me ligjin dhe rregullore në fuqi.
5. Dërgimi të Kryetari i Komunës për miratim të ofertës se përzgjedhur për dhënien afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës dhe çështje tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme nga Komisioni Vlerësues.

6. Administrata e Komunës i ofron përkrahje Komisionit Vlerësues për dhënies në shfrytëzim të pronës Komunale.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
8. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT
Z. Rexhep Kurtbogaj